



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 99/6 Prot

Tiranë, më 21/02/2020

VENDIM

Nr. 05, datë 21.02.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 99 Prot., datë 17.01.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Drejtësisë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesave datë 07.01.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Listën e Përmbauesve Gjyqësor Privat të licensuar nga Ministria e Drejtësisë, me provim ose me përjashtim ligjor, për periudhën 2010 – 2016.*
2. *Listën emërore dhe të dhënat bashkëlidhur urdhrin nr. 990, datë 04.02.2016 të Ministrit të Drejtësisë.*

Autoriteti publik me shkresën nr. R 2/2 Prot., datë 13.01.2020 ka kthyer përgjigje duke referuar faqen zyrtare në të cilën është publikuar lista e përmbauesve gjyqësor privat aktiv, të licensuar nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu bashkëlidhur shkresës, kërkuesit i është vënë në dispozicion kopje e urdhrin nr. 990, datë 04.02.2016 të Ministrit të Drejtësisë.

Pas përgjigjes së dhënë nga autoriteti publik, ankuesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, ankesën nr. 99 Prot., datë 17.01.2020, me objekt “*refuzimin e dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, duke kërkuar nga Komisioneri

ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Nga sa është parashtruar në ankesë, ankuesi pretendon se nuk i është vënë në dispozicion lista e Përmbardhësve Gjyqësor Privat të liçensuar nga Ministria e Drejtësisë me provim ose me përjashtim ligjor, për periudhën 2010 – 2016, por i është cituar faqja zyrtare e autoritetit ku gjendet i publikuar pjesërisht informacioni (vetëm përmbardhësit aktiv). Gjithashtu, ankuesit nuk i është vënë në dispozicion kopje e listës emërore dhe të dhënash bashkëlidhur (relacione, memo) Urdhrit nr. 990, datë 04.02.2016 të Ministrit të Drejtësisë, por vetëm urdhri i sipërcituar.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij. Në këtë kuadër, pas vlerësimit të ligjshmërisë së ankimit, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me qëllim verifikimin e pretendimeve të ankuesit, nëpërmjet *e-mail*-it datë 22.01.2020, si hap paraprak, i ka kërkuar autoritetit publik, rivlerësimin e dhënies së informacionit të kërkuar.

Në përgjigje të *e-mail*-it të sipërcituar autoriteti publik, me anë të shkresës nr. R 2/4 Prot., datë 04.02.2020 argumentoi se ankuesit i është vënë në dispozicion informacioni me shkresën nr. R 2/2 Prot., datë 13.01.2020.

Nga përgjigja e kthyer, Zyra e Komisionerit konstatoi se autoriteti publik mban të njëjtin qëndrim që ka mbajtur edhe në përgjigjen e parë që i ka thyer kërkuarit, duke refuzuar dhënien e plotë të informacionit në përputhje me objektin e kërkesës së ankuesit.

Në vijim, Komisioneri me Urdhrin nr. 27, datë 11.02.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë autoritetit publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion.

Pas depozitimit të urdhrit, grupi i inspektimit kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit duke kërkuar kopje të kërkesave për informim objekt shqyrtimi administrativ, të administruara nga autoriteti, me qëllim evidentimin e personit/ave përgjegjës për ndjekjen/trajtimin e kërkesave në përmbushjen e detyrimit për informim.

Koordinatorja vendosi në dispozicion të grupit të inspektimit kopje të kërkesave të z. të administruara në protokollin e autoritetit me nr. R-2 prot., datë 07.01.2020 dhe nr. R-2/1 prot., datë 07.01.2020. Nga këqyrja e tyre rezulton se Sekretari i Përgjithshëm ka ngarkuar për trajtim Drejtorinë e Derregullimit të Lejeve Licencave dhe Monitorimit. Gjithashtu, u këqyr kopja e shkresës kthim përgjigje nr. R 2/2 Prot., datë 13.01.2020, si edhe shkresa nr. R 2/4 Prot., datë 04.02.2020, që është trajtuar nga kjo drejtori.

Grupi i inspektimit kontaktoi edhe me personat përgjegjës, të cilët kanë trajtuar kërkesën për të konfirmuar nëse informacioni i kërkuar disponohet nga autoriteti publik, si dhe për

të administruar qëndrimin përfundimtar të nëpunësve të ngarkuar me çështjen objekt inspektimi.

Në lidhje me pikën 1, përfaqësuesit e autoritetit sqaruan se: *Ministria e Drejtësisë në respektim të parashikimeve ligjore të mëparshme me ligjin Nr.10 031, datë 11.12.2008, "Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat", i ndryshuar, edhe në ligjin e ri për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat, ka publikuar në faqen web të saj, regjistrin e përmbartuesve gjyqësorë privatë, faqja zyrtare ku qytetari është orientuar të konsultohet me regjistrin e përmbartuesve gjyqësorë privatë aktivë të cilët ushtrojnë efektivisht profesionin, të licencuar nga viti 2010 deri në vitin 2016 ku në total janë 158 përmbartues. Në këtë listë nuk janë të përfshirë përmbartuesit të cilëve iu është hequr licenca (si rezultat i dorëheqjes nga profesioni apo marrjes së masës disiplinore të heqjes së certifikatës dhe çregjistrimit nga regjistri) ose të cilët kanë kërkuar pezullimin e aktivitetit, në këtë kuadër kërkesa për informim nuk është kuptuar drejtë dhe është konsideruar e përmbushur. Megjithatë, deklarohet se duke qenë se qytetari kërkon listën e plotë (edhe përmbartuesit jo aktivë) përmbartuesve të cilët nuk janë përfshirë në listën që i është bërë me dije kërkuarit, do të kryhen verifikimet në regjistrin fizik të përmbartuesve privatë në mënyrë që ti vihet në dispozicion informacioni kërkuarit.*

Në lidhje me pikën 2, ku kërkohet lista emërore bashkëlidhur Urdhrit nr. 990, datë 04.02.2016 të Ministrit të Drejtësisë u sqarua se: *Më datë 08.01.2020 nëpërmjet e-mail-it u kërkuar nga sektori i protokoll arkivës kopja e dokumentit të kërkuar, Urdhrit (2 fletë), i cili u nxorr nga arkivi me shënimin; "përveç Urdhrit nuk ka asnjë dokument bashkëlidhur", me nënshkrimin si nga punonjësja që ka tërhequr dokumentin ashtu edhe nëpunësja e protokollit, me qëllim vendosjen në dispozicion kërkuarit. Gjithashtu, u sqarua se sektori i arkiv protokollit të Ministrisë së Drejtësisë është në fazë risistemimi, për këtë arsye në kthim përgjigjen ndaj qytetarit u vu në dispozicion materiali që u gjet në respektim të afatit kohor ligjor në përputhje me të drejtën e informimit, por në çdo rast përfaqësuesit shprehën gadishmërinë për vënien në dispozicion të qytetarit menjëherë sapo të gjendet lista e kërkuar.*

Pas konsultimit të legjisllacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga autoriteti publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë. Autoriteti publik ka pasur në dispozicion afatin kohor të mjaftueshëm për të përmbushur objektin e kërkesës për informim.

Në lidhje me argumentin e dhënë nga autoriteti publik, për kërkesën për listën e përmbartuesve të licensuar për periudhën 2010-2016, për të cilin autoriteti pretendon se ka qenë e paqartë, Komisioneri vlerëson se argumenti i parashtruar nuk qëndron. Referuar pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", "Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuarin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuarin në saktësimin e kërkesës." Për sa më sipër, autoriteti nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar në dispozitën e sipërcituar

dhe për rrjedhojë argumenti i parashtruar nuk mund të pranohet për shkak se është i pabazuar në ligj.

Nga hetimi administrativ rezultoi se Ministria e Drejtësisë ka informuar kërkuesin duke cituar faqen zyrtare të autoritetit në të cilën gjendet regjistri i përmbaruesve gjyqësorë privatë aktiv të cilët ushtrojnë efektivisht profesionin, përmbarues këta të licencuar nga viti 2010 deri në vitin 2016. Ndërkohë që kërkuesi, ka kërkuar të informohet për listën e përmbaruesve të licencuar (duke mos e ndarë aktiv dhe jo aktiv) për periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2016.

Në lidhje me kërkesën për kopje të Urdhrit nr. 990, datë 04.02.2016 të Ministrit të Drejtësisë, së bashku me dokumentet shoqërues të cituar në këtë urdhër, përfaqësuesit e autoritetit publik pranojnë se, me qëllim shmangien e vonesave dhe respektimin e afatit ligjor për kthimin e përgjigjes, kërkuesit i është vendosur në dispozicion vetëm Urdhri i sipërcituar, për shkak se nga sektori i arkiv protokollit nuk është bërë e mundur gjetja e dokumentacionit bashkëlidhur.

Nga hetimi nuk rezultoi i provuar fakti i ekzistencës së këtij dokumentacioni, për shkak se bazuar në deklaratimet e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, sektori i arkiv protokollit është në fazë risistemimi dhe është praktikisht e pamundur nxjerrja e dokumenteve. Pavarësisht kësaj, nëpunësit shprehën gadishmërinë që pas verifikimit të dokumentacionit, informacioni t'i vihet në dispozicion kërkuesit.

Në lidhje me sa u parashtrua, Komisioneri vlerëson se autoriteti ka proceduar duke përmbushur pjesërisht objektin e kërkesës për informim, për arsye të pamundësisë objektive. Megjithatë në çdo rast autoriteti nuk përjashtohet nga detyrimi për dhënien e informacionit.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i çështjes rezulton se informacioni i kërkuar nga z.

, përmbush kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. \_\_\_\_\_ ndaj Ministrisë së Drejtësisë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 99 Prot., datë 17.01.2020 të z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Drejtësisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në lidhje me:
  1. Listën e Përmbauesve Gjyqësor Privat të liçensuar nga Ministria e Drejtësisë, me provim ose me përjashtim ligjor, për periudhën 2010 – 2016.
  2. Listën emërore dhe të dhënat bashkëlidhur urdhrit nr. 990, datë 04.02.2016 të Ministrisë të Drejtësisë, brenda datës 28.02.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 21.02.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

